

**VENDIM**  
**Nr. 464, datë 26.7.2023**

**PËR FUNKSIONIMIN, ORGANIZIMIN DHE MËNYRËN E ZHVILLIMIT TË  
VEPRIMTARISË TË QENDRËS RAJONALE PËR KONSERVIM DHE  
RESTAURIM**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 9, të nenit 29, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

**I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

1. Funksionimin dhe mënyrën e organizimit të Qendrës Rajonale për Konservim dhe Restaurim (në vijim QRKR) pranë Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore.

2. Misioni i QRKR-së është formimi dhe përditësimi i njohurive të restauratorëve dhe të subjekteve të licencuara, sipas legjislacionit për trashëgiminë kulturore, hartimi dhe zbatimi i programeve të kualifikimit të specialistëve në fushën e trashëgimisë kulturore materiale.

3. QRKR-ja e shtrinë veprimtarinë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, në këto fusha përgjegjësie:

a) ofrimin e programeve, trajnimeve, seminareve, kurseve të formimit profesional në fushën e trashëgimisë kulturore;

b) ofrimin e programeve të formimit fillestar fizikisht ose nëpërmjet platformave digjitale, paketës *e-learning*;

c) hartimin dhe zbatimin e programeve të kualifikimit në fushën e trashëgimisë kulturore materiale;

ç) administrimin e procesit të marrjes së krediteve për përfitimin e licencave profesionale në fushën e trashëgimisë kulturore;

d) rritjen e ndërgjegjësimin të publikut lidhur me trashëgiminë kulturore, teknikat e konservimit, restaurimit, si dhe menaxhimit të pasurive kulturore materiale.

4. QRKR-ja realizon misionin e parashikuar në shkronjat “a”, “b” dhe “c” nëpërmjet kontraktimit të trajnerëve vendas dhe të huaj. Trajnerët e jashtëm kontraktohen sipas legjislacionit në fuqi.

5. Formimi dhe përditësimi i njohurive të specialistëve, restauratorëve dhe subjekteve të licencuara në fushën e trashëgimisë kulturore janë me ose pa pagesë, sipas përcaktimeve me urdhër të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

6. Tarifat për formimin dhe përditësimin e njohurive të specialistëve përcaktohen me urdhër të përbashkët të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore dhe ministrit përgjegjës për financat. Të ardhurat e siguruara nga këto tarifa, përdoren për pagesat e trajnerëve të jashtëm.

7. Në buxhetin e Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, në pjesën për “shpenzime korrente”, miratohet një fond i veçantë buxhetor për realizimin e misionit të QRKR-së.

**II. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I QENDRËS RAJONALE PËR KONSERVIM DHE RESTAURIM**

1. QRKR-ja drejtohet dhe përfaqësohet nga drejtori, i cili organizon dhe drejton veprimtarinë e QRKR-së dhe përgjigjet përpara drejtorit të Përgjithshëm të IKTK-së dhe ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

2. Drejtori i QRKR-së emërohet nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore, me propozimin e drejtorit të Përgjithshëm të IKTK-së.

3. QRKR-ja realizon aktivitetin nën monitorimin e IKTK-së dhe në bashkëpunim me:

a) institucionet e tjera në varësi të ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore;

b) organet e administratës qendrore;

c) organet e vetëqeverisjes vendore;  
ç) institucionet e tjera shkencore, kulturore, fetare, personat fizikë e juridikë.  
4. Marrëdhëniet e punës së drejtorit dhe të punonjësve të QRKR-së rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë.

5. Statuti dhe rregullorja, që përcaktojnë metodat e brendshme të punës së QRKR-së, miratohen nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

### III. PËRGJEGJËSIA FUNKSIONALE E QENDRËS RAJONALE PËR KONSERVIM DHE RESTAURIM

QRKR-ja ka përgjegjësi të funksionale, si më poshtë vijon:

a) realizon çdo funksion që lidhet me formimin e vazhdueshëm profesional në fushën e trashëgimisë kulturore materiale;

b) siguron kushtet për mundësinë e shkëmbimeve të vazhdueshme profesionale, duke ofruar një platformë bashkëpunimi me institucione publike, jopublike, qendra kërkimi shkencor, qendra profesionale, kombëtare dhe ndërkombëtare;

c) analizon dhe vlerëson nevojat për burime të domosdoshme, si burime njerëzore, financiare, objekte, pajisje, mekanizma financimi, për ofrimin cilësor të formimit dhe përditësimit të njohurive të restauratorëve dhe të subjekteve të licencuara, sipas legjislacionit për trashëgiminë kulturore;

ç) planifikon organizimin dhe shtrirjen e shërbimeve të formimit dhe përditësimit të njohurive profesionale;

d) siguron dhe optimizon burimet financiare si dhe planifikon buxhetin në terma afatshkurtër e afatmesëm;

dh) bashkërendon punën me institucionet përgjegjëse në fushën e trashëgimisë kulturore, si dhe partnerët kombëtarë dhe ndërkombëtarë, për të mbështetur ofrimin me cilësi të funksioneve të përcaktuara në këtë vendim;

e) ndërton sistemin e menaxhimit të performancës, bazuar në objektiva, si dhe zhvillon e monitoron sistemet e brendshme të vlerësimit;

ë) mban dhe përditëson regjistrin me certifikatat e lëshuara;

f) ka të drejtë, në kuadër të ushtrimit të përgjegjësi të funksionale të themelojë, të jetë anëtar ose të marrë pjesë në organet drejtuese të organizatave jofitimprurëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

### IV. KRITERET PËR TRAJNERËT DHE PAGESA E TYRE

1. Qendra ka këto kategori të trajnerëve:

a) trajnerë të brendshëm;

b) trajnerë të jashtëm.

2. Kriteret e përgjithshme për trajnerët e jashtëm, të cilët ofrojnë shërbimet e tyre për Qendrën, bazuar në legjislacionin e zbatueshëm për këtë kategori shërbimesh, janë, si më poshtë vijon:

a) të punojnë ose të kenë eksperiencë pune në institucionet e specializuara të trashëgimisë kulturore;

b) të jenë asistent lektor, lektor, profesor;

c) të kenë ekspertizën që kërkojnë programet specifike të trajnimit.

3. Për zhvillimin e trajnimeve, Qendra lidh me trajnerët e jashtëm kontratë, me objektin e mëposhtëm:

a) kontratë për trajnimin e specialistëve, në fushën e trashëgimisë kulturore materiale, restauratorëve dhe të subjekteve të licencuara në përputhje me ligjin nr. 27/2018;

b) kontratë për hartimin e kurrikulave dhe materialeve trajnuese;

c) kontratë për trajnimin e trajnerëve (ToT), kur është e nevojshme.

4. Trajnerët e jashtëm, me të cilët lidhen kontratat, sipas shkronjave “a” dhe “c”, të pikës 3, të këtij vendimi, ndahen në kategoritë e mëposhtme:

a) trajnerë të jashtëm të kategorisë së ulët janë trajnerët që kanë një diplomë “Master i shkencave” ose “Master i arteve” ose “Master profesional, të përfutur në fund të studimeve të

ciklit të dytë, me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 (dy) vite akademike” apo të barasvlershme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë, dhe 3 (tre) – 5 (pesë) vite përvojë pune në fushën përkatëse, për të cilën do të ofrojnë trajnimin;

b) trajnerë të jashtëm të kategorisë së mesme janë trajnerët që kanë një diplomë “Master i shkencave” ose “Master i arteve” ose “Master profesional të përfituar në fund të studimeve të ciklit të dytë, me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 (dy) vite akademike” apo të barasvlershme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë, dhe 6 (gjashtë) – 10 (dhjetë) vite përvojë pune në fushën përkatëse, për të cilën do të ofrojnë trajnimin;

c) trajnerë të jashtëm të kategorisë së lartë janë trajnerët që kanë një diplomë “Master i shkencave” ose “Master i arteve” ose “Master profesional të përfituar në fund të studimeve të ciklit të dytë, me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 (dy) vite akademike” apo të barasvlershme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë, dhe mbi 11 (njëmbëdhjetë) vite përvojë pune në fushën përkatëse, për të cilën do të ofrojnë trajnimin.

5. Trajnerë të jashtëm, me të cilët lidhen kontratat e parashikuara në shkronjën “b”, të pikës 3, zgjidhen individët që plotësojnë kriteret për të qenë trajnerë të jashtëm të kategorisë së lartë.

6. Masa e pagesës për trajnerët e jashtëm përcaktohet në kontratë dhe llogaritet në varësi të kategorisë së trajnerit e të orëve të trajnimit, përkatësisht:

a) për kontratat e parashikuara në shkronjat “a” dhe “c”, të pikës 3, të këtij kreu, masa e pagesës për çdo orë trajnimi 60-minutëshe për:

i. trajnerët e jashtëm të kategorisë së ulët të jetë 750 (shtatëqind e pesëdhjetë) lekë;

ii. trajnerët e jashtëm të kategorisë së mesme të jetë 1 000 (një mijë) lekë;

iii. trajnerët e jashtëm të kategorisë së lartë të jetë 1 500 (një mijë e pesëqind) lekë;

b) për kontratat e parashikuara në shkronjën “b”, të pikës 3, të këtij kreu, masa e pagesës për hartimin e kurrikulave apo të materialeve të trajnimit, të nevojshme për zhvillimin e 6 (gjashtë) orëve 60-minutëshe, të jetë 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë;

c) në rastet e hartimit të kurrikulave apo të materialeve të trajnimit për më pak ose më shumë se 6 (gjashtë) orë trajnimi 60-minutëshe, pagesa llogaritet në përpjesëtim me orët e trajnimit;

ç) në rastet e rishikimit të kurrikulave, pagesa të jetë deri në 50 (pesëdhjetë) % të pagesës së përcaktuar, sipas shkronjës “b”, të kësaj pike.

## V. BOTIMET DHE PRODUKTET INTELEKTUALE

1. Qendra bën botime ose publikime në fushat përkatëse.

2. E drejta e autorit për botimet dhe publikimet e kryera, të krijuara nga trajnerët, përfshirë trajnerët e jashtëm apo nga personat që trajnohen nga Qendra, rregullohet në bazë të legjislacionit për të drejtën e autorit.

## VI. DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

1. Ngarkohet Ministria e Kulturës të propozojë ndryshimin e strukturës dhe organikës së Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, brenda 6 (gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Kulturës, Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR  
**Belinda Balluku**